



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.01.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të zhvilluara në datat 17, 18 dhe 19 dhjetor 2018.
2. Miratimi i draft-kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 21 janar – 8 shkurt
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin shtesë të projektit “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr. 40/2012”

Marrin pjesë:

Ulsi manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Silva Caka, Elena Xhina dhe Tom Doshi

Mungon:

Damian Gjikhuri, Oert Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çypi. Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço

Të ftuar:

Dorina Çinari – Zëvendësministre e Infrastrukturës dhe Energjisë

Agim Bregasi – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Fatmir Elezi – përfaqësues nga KESH-i

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëdita!

Të nderuar kolegë deputetë, përfaqësues të medieve dhe të tjerë të pranishëm, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut nis sot punën e sesionit të ri parlamentar për vitin 2019.

Si kryetar i këtij komisioni dua t'ju uroj një vit të mbarë në familjet e secilit prej jush, por edhe një vit të suksesshëm parlamentar në përmbushje të detyrës sonë si deputetë të Kuvendit të Shqipërisë.

Unë besoj se përtej qëndrimeve politike që na dallojnë si mazhorancë dhe opozitë, ajo që duhet të na bashkojë në këtë komision është logjika e ftohtë juridike, në mënyrë që t'u japim qytetarëve ligje sa më të mira, gjë që është në traditën më të mirë të punës së Komisionit të Ligjeve të Kuvendit të Shqipërisë.

Gjatë këtij sesioni parlamentar do të përmirësojmë dhe thellojmë bashkëpunimin me medien, që, për hir të së vërtetës, kanë qenë zëri dhe fytyra e transparencës së punës tonë në sytë e publikut.

Në emër të komisionit dua t'i uroj suksese në detyrën e ministrit të Bujqësisë, zotit Çuçi. Jam i bindur që eksperiencia e tij në Komisionin e Ligjeve do t'i shërbejë si një përvojë e vyer në menaxhimin më të mirë të këtij institucioni.

Gjithashtu, dua t'i uroj mirëseardhjen në tryezën e punës së këtij komisioni kolegut tonë, zotit Gjikhuri, i cili sot mungon për shkak të një angazhimi jashtë vendit. Jam i bindur që do të jetë një vlerë e shtuar e këtij komisioni jo vetëm me përvojën e tij të gjatë si jurist, por edhe si menaxher i një prej sektorëve më të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare, siç është energjetika dhe transporti.

Po them dy fjalë shkurtimisht për punën e Komisionit të Ligjeve, në sesionin parlamentar të vitit 2018.

Komisioni ynë si një nga komisionet më të rëndësishme të Kuvendit të Shqipërisë ka përballuar një veprimtari të ngjeshur legjislativë në të tri komponentët e kësaj veprimtarie, si në atë të ligjërjes, të kontrollit parlamentar, si dhe të zgjedhjes apo emërimit e organeve të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj.

Aktivitetin e këtij komisioni për vitin 2018 ne do t'ua bëjmë prezent shumë shpejt edhe medieve, por unë po jap disa të dhëna statistikore. Komisioni për vitin 2018 ka zhvilluar 89 mbledhje, 156 orë debate dhe numri i amendamenteve që ka miratuar ky komision është 664. Nga 88 projektligjet që janë miratuar, 24 janë shqyrtuar në cilësinë e komisionit

përgjegjës dhe 63 si komision për dhënie mendimi. Këtu kam parasysh të gjithë paketën e projektligjeve të mbetura të reformës në drejtësi.

Në këtë sesion parlamentar ne do të përmbylim edhe dy ligjet e fundit të paketës së reformës në drejtësi, që është projektligji “Për Policinë Gjyqësore”, projektligji “Për shërbimin përmbartimor privat” dhe projektvendimi “Për draftstrategjinë e edukimit ligjor”.

Edhe një herë shumë faleminderit për angazhimin e gjithë kolegëve të mi deputetë në sesionin parlamentar të vitit që lamë pas, por njëkohësisht dua t’u uroj të gjithë deputetëve, pozitë dhe opozitë, mbarësi, me krahë të lehta dhe na shkoftë mbarë ky sesion i ri parlamentar.

Unë jam i bindur që do të ketë debate të vazhdueshme, ashtu siç janë pozicionuar palët në qëndrimet e tyre politike, por në fund të ditës ajo për të cilën jemi votuar dhe jemi prezent në këtë komision është miratimi i projektligjeve, që vijnë si nga Këshilli i Ministrave, ashtu edhe nga iniciativat e kolegëve deputetë.

Uroj që gjatë këtij sesioni parlamentar numri i projektligjeve që do të propozohen apo do të vijnë si iniciativa të deputetëve të jetë akoma më i madh në numër.

Faleminderit!

Vazhdojmë me rendin e ditës. Kemi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të zhvilluara në datat 17, 18 dhe 19 dhjetor të vitit 2018.

A jeni dakord me procesverbalet? Dakord.

Miratojen procesverbalet.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, miratimi i draftkalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 21 janar – 8 shkurt. Kalendari është mbi tryezat e kolegëve.

A ka vërejtje për kalendarin? Nuk ka.

Miratohet draftkalendarin i punimeve të komisionit për periudhën 21 janar, datë 8 shkurt.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës, që është shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin shtesë të projektit “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr. 40/2012”. Komisioni ynë në shqyrtimin e këtij projektligji është për dhënie mendimi.

Relator është kolegu Edmond Leka.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Energjetikës zonja Dorina Çinari, zëvendësministre. Mirë se keni ardhur, zonja zëvendësministre!

Gjithashtu, zoti Agim Bregasi, drejtor, dhe zoti Fatmir Elezi nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare.

Pa humbur kohë fjalën ia kaloj zonjës Çinari për të bërë një prezantim të shkurtër të projekt marrëveshjes dhe më pas do t'ia kaloj relatorit.

Fjala për ju.

Dorina Çinari – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar zotërinj deputetë, qëllimi i projektligjit është ratifikimi i letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas, për shtesën e financimit të projektit “Siguria e digave”, nënshkruar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, ratifikuar me ligjin nr. 40/2012.

Në marrëveshjen bazë të ratifikuar me ligjin nr. 40, të vitit 2012 ka qenë i parashikuar financimi prej 15.5 milionë eurosh, e ndarë si më poshtë:

15 milionë euro për investime në kategorinë e parë, 38750 euro komisione bankare dhe 465250 euro të pa alokuara. Ky financim është në vazhden e financimeve për projektin e sigurisë së digave, ku ku janë të përfshirë katër donatorë të mëdhenj: si Banka Botërore, SEKO, KFW dhe IBRD. Në këtë akt ne kemi nevojë të riallokojmë pjesën e pa përdorur të fondeve prej 461250 eurosh, nga zëri “asistencë teknike” në zërin “punime civile” ose “investime”, që është zëri i kategorisë së parë. Riallokimi i fondeve bëhet pa ndryshuar fondin tavan, që është 15.5 milionë euro, fond ky i papërdorur, për të kaluar nga zëri “asistencë teknike” në zërin “punime të infrastrukturës dhe civile”.

Punimet e infrastrukturës në sigurinë e digave kanë katër komponentë: siguria fizike e digës, montimi i portave të shkarkimit të heceve dhe kaskadës së lumit Drin, montimi i turbinave dhe sistemet e monitorimit të kaskadës, të agregateve dhe të tjera. Këta janë katër komponentët kryesorë që hyjnë në zërin “punime infrastrukturore dhe civile”, të cilave kërkojmë që t’i shtojmë fondin prej 461250 eurosh. Pra, nevoja jonë është riallokimi i fondeve brendapërbrenda.

Gjithashtu, kërkojmë shtyrjen e afatit për disbursimin e plotë të huasë nga viti 2019 deri në fund të vitit 2020, sepse punimet civile kërkojnë kohë për t’u implementuar.

Nëse keni pyetje, jemi gati t’u përgjigjemi.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Çinari!

Fjalën e ka zoti Leka.

Edmond Leka – Faleminderit, kryetar!

Sic e tha edhe zonja zëvendësministre, qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi i letërmarrëveshjes së ndryshuar të marrëveshjes së huasë për rehabilitimin e digave. Dua të sqaroj që aktiviteti për sigurinë e digave ka një natyrë specifike dhe varet gjithmonë nga momenti i ndërhyrjes në digë. Vetëm kur ndërhyrja në riparimin e turbinave apo të agregateve të gjeneratorëve mund të shikosh se çfarë nevojash të tjera kanë ato që nuk janë parashikuar në këtë aktmarrëveshje. Këtu po flas kryesisht për agregatet 1, 2 dhe 3 në hidrocentralin e Komanit, të cilat kanë nevojë për ndërhyrje për t'u riparuar. Nuk bëhet fjalë për fonde shtesë, sepse është një vlerë prej 461 milionë eurosh, që do të kalojnë për mallra dhe punime në rehabilitimin e këtyre agregateve të hidrocentralit.

Gjithashtu, kërkohet edhe shtyrja në kohë e kësaj marrëveshjeje deri më 31 dhjetor të vitit 2020, sepse ka nevojë për disa rregullime të teknikës legjislative. Kryesisht te baza ligjore e projektligjit duhet të bëhet që është në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, dhe nenit 121/1 të Kushtetutës me propozimin e Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, ky projektligj duhet të ndahet në dy nene me përmbajtje: neni 1 të jetë ratifikimi i marrëveshjes dhe neni 2 të jetë hyrja në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Në aspektin ligjor dhe procedural kjo marrëveshje është në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren.

Unë kam dy pyetje për zëvendësministren: së pari, a do të kërkohen fonde shtesë përveç këtij fondi, të cilin ne mendojmë ta përdorim për riparimin e agregateve? Pra, a do të ketë nevojë për fonde shtesë, që të përmbillet ky riparim i nevojshëm në turbina?

Së dyti, ne e dimë që në hidrocentralet tona kemi humbje, por në hidrocentralin e Komanit kemi një humbje me 10%, që vjen kryesisht nga mospërputhja e portave. A do të kemi rritje të rendimentit në bazë të këtij riparimi, që do të kryejmë në turbina dhe në gjeneratorë? Pra, a do të rritet rendimenti pas këtyre riparimeve në hidrocentralin e Komanit?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Leka!

Atëherë, një përgjigje rreth pyetjeve?

Po, zoti Bregasi.

Agim Bregasi – Faleminderit!

Atëherë, sikurse e përmendi edhe relatori, këto fonde do të përdoren kryesisht për agregatin numër 4, pasi janë hapur agregatet 1, 2 dhe 3 dhe është bërë rehabilitimi i tyre. Ne kemi vërejtur se punimet që duhet të bëhen tek agregati numër 4 janë më të thella se sa ishte parashikuar para 10 vjetësh. Kjo vjen jo vetëm për faktin se kur bëhet planifikimi i fondeve gjithmonë parashikohet të ketë një fond shtesë 5% për të gjitha të papriturat, por edhe sikur

parashikimi të ishte fiks, kanë kaluar 10 vjet, ndaj normal që ka ndodhur një amortizim i elementeve të turbinës dhe gjeneratorit. Pra, kjo është parë e nevojshme që të bëhet.

Për sa u përket financimeve shtesë për këtë agregat, nuk do të ketë më, sepse konsiderohet që do të mbyllet me këtë financim që kemi.

Në lidhje me pyetjen për humbjet në masën 10%, nga portat kjo është tjetër gjë dhe nuk lidhet me këtë financim, por lidhet me një financim që Kuvendi ka miratuar në shtator të vitit të kaluar në shifrën 12 milionë euro, ku do të bëhen ndërhyrje edhe në portat e hidrocentralit të Fierzës, edhe në portat e hidrocentralit të Komanit. Natyrisht, financimi shkon jo vetëm për rritjen e sigurisë në diga, por edhe për rritjen e eficiencës në mënyrë indirekte, sepse, duke pasur siguri të portat, mund të punosh edhe me kuota më të larta dhe nuk ke rrezikshmëri, por ke bindjen e plotë që je brenda sigurisë së kërkuar. Pra, 10%-shi mund të diskutohet kur të mbarojë financimi prej 12 milionë eurosh, i cili është miratuar në Kuvend.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Bregasi!

A ka pyetje nga kolegët?

Po, zonja Caka.

Silva Caka – Në fakt, kam dy pyetje.

Pyetjen e parë do të doja t'ia drejtoja zëvendësministres në lidhje me një shqetësim që është ngritur nga banorët e fshatrave rreth lumit Mat. Sigurisht, nuk është përgjegjësia juaj totale, por dua të di nëse keni informacion. A ka një bashkëpunim ndërministror midis jush dhe Ministrisë së Bujqësisë? Në vitin 2017 janë dhënë rreth 35 licenca për shfrytëzim inertesh përgjatë lumit Mat, të cilat janë abroguar një vit më pas dhe janë dhënë rreth 5 ose 6 licenca, të cilat unë i konsideroj totalisht selektive dhe favorizuese kundrejt disa subjekteve, të cilat nuk kanë një projekt të qartë për sa i përket shfrytëzimit të inerteve, por janë thjesht subjekte, që zhvillojnë koncesione të ndryshme në punët publike. Ideja është se duke vazhduar me këtë shfrytëzim të materialeve inerteve të lumit Mat dhe në mënyrë të pakontrolluar dhe abuzive, a rrezikohet diga që bashkon lumin Mat me lumin Fan? Pra, është duke u shfrytëzuar shtrati në një mënyrë të pakontrolluar dhe nuk është çështja vetëm të diga, por të mos harrojmë se lumi Mat është një lumë me shumë prurje, ka një shtrat rreth 900 metra të gjerë dhe mbi të gjitha, nëse do të vazhdohet të punohet në mënyrë të pakontrolluar, rrezikohen edhe fshatrat përreth. Unë nuk mendoj se është totalisht përgjegjësia juaj, por përgjegjësia juaj është pikërisht sigurimi i digave, meqenëse keni sjellë këtë projektligj sot. A keni ju një bashkëpunim ndërministror për të parë nëse këto punime po rrezikojnë digën e lumit Mat konkretisht?

Së dyti, kam një pyetje për përfaqësuesin e Korporatës, zotin Elezi.

Zoti Elezi, në tetor të vitit 2018, të më falni për datën se nuk e kam të qartë, Sekretariati i Energjisë së Vjenës i ka drejtuar një shkresë Autoritetit të Konkurrencës lidhur me mënyrën e zhvillimit të tenderëve në Koorporatën Elektroenergjetike Shqiptare, e cila dyshohet që të jetë korruptive dhe, sigurisht, favorizuese kundrejt dy subjekteve, të cilat besoj se ju e keni të qartë se për çfarë bëhet fjalë. Unë do të doja të dija nëse është ngritur ndonjë hetim për këto dy çështje?

Së dyti, a ju ka ardhur juve një shkresë nga Autoriteti i Konkurrencës dhe a jeni përgjigjur ju si institucion?

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit, zonja Caka!

Zonja ministre, a keni ndonjë përgjigje për pyetjet e koleges?

Dorina Çinari – E falënderoj zonjën Caka për shqetësimin për sa i përket shtatit të lumit Mat dhe problematikave rreth e qark, por kjo nuk është në fushën e mbulimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Gjithsesi, ne jemi gjithmonë të gatshëm për bashkëpunime të çfarëdolloji në shërbim të këtyre proceseve.

Silva Caka – Unë e thashë vetë në parantezë, që kjo nuk është fusha juaj e mbulimit, por punimet e bëra, në mënyrë të pakontrolluar dhe marrja e materialeve inerte në mënyrë të pakontrolluar, siç unë e faktova, po rrezikojnë sigurinë e digës së vetme të lumit Mat. A keni ju ndonjë informacion për këtë gjë?

Dorina Çinari – Unë nuk kam asnjë informacion për këtë gjë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Çinari!

(Diskutime pa mikrofon.)

Shqetësimi është i drejtë, sepse, duke u gërryer lumi Mat deri poshtë në Milot, diga e Komanit mund të pësojë rrezik.

Zoti Fino, ka kërkuar fjalën për pyetje.

Bashkim Fino - Faleminderit, kryetar!

Unë kam dy sugjerime. Çfarë po na thonë përfaqësuesit e ministrisë sot? Ata po thonë se kanë marrë një hua, të cilën e kemi miratuar ne. Pra, është një hua, nga të cilat për mallra dhe punime do të përdorëshin 15 milionë euro, ndërsa asistenca teknike do të ishte 461,250 mijë euro. Në përgjithësi, kur ne i diskutojmë këto hua, gjithmonë unë bëj sugjerime dhe vërejtje për sa u përket asistencave e të tjerë. Këta thonë sot se nuk e kanë planifikuar mirë, që shifrën 461 mijë euro ishte vendosur më tepër për asistencë teknike dhe nuk u duhen

dhe po thonë që këtë shifër ta kalojnë tani tek investimet. Pra, nga 15 milionë, që ishte tani është 15 milionë e 461 mijë euro.

Pyetja që kam unë dhe që më bezdis në raste të tilla është planifikimi jo i saktë dhe i drejtë kur ne bëjmë huamarrjen dhe këtu vërtetohet se nuk është bërë i saktë dhe i rregullt, pra ato vërejtje që kemi bërë ne.

Së dyti, unë jam gjirokastrit dhe dua të kursej. Pra, sa më pak të harxhojmë ne, aq më pak hua kanë fëmijët tanë dhe ju, apo jo? Pyetja ime është: kur KESH-i është me fitim ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, më lini të mbaroj se e kam seriozisht dhe nuk e kam për të qeshur!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A mund të vazhdoj, zoti kryetar?

Ulsi Manja – Po, vazhdoni zoti Fino!

Bashkim Fino – Pra, sa më pak fonde të harxhohen, aq më pak hua është. Në rastin konkret, kur KESH-i është me fitim, pse nuk përdor nga fitimet e tij për të vazhduar investimin, në mënyrë që të mos vazhdojmë të marrim hua, të cilat i paguajmë të gjithë ne bashkërisht?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Nga Ministria e Energjetikës kush do të përgjigjet?

Dorina Çinari – Faktikisht KESH-i është angazhuar vazhdimisht gjatë gjithë kohës me në punime të rehabilitimit të kaskadës së Drinit i ka përdorur fondet e saj. Këto janë marrëveshje të miratuara që në vitin 2012, me një plan masash me aktivitete konkrete. Ne vetëm po bëjmë rialokime fondesh dhe nuk ka fonde shtesë, madje po i kalojmë nga zëri i asistencës teknike në infrastrukturë.

Ulsi Manja – Edhe zoti Fino këtë po thoshte, që shifra 461 mijë euro, që po kërkoni të rialokimi, ka qenë e planifikuar për asistencë teknike dhe tani po kaloni te zëri i investimeve. Pra, është çështje planifikimi.

Dorina Çinari – Po, nevojat janë, sepse ka punime shumë të fshehura. Pra, ka punime...

(Diskutime pa mikrofon.)

Ulsi Manja - Ju lutem, të mbarojë fillimisht zonja Çinari lidhur me pyetjen e zotit Fino dhe më pas ju.

Dorina Çinari - Studimi i fizibilitetit, që i ka paraprirë kësaj marrëveshjeje, është bërë para vitit 2012. Pra, në atë kohë janë bërë disa studime dhe sot jemi para faktit konkret,

ka filluar ekzekutimi i projektit dhe si në çdo punim infrastrukturor civil ka gjithmonë punime të fshehura që nuk parashikohen dot në kohë. Për më tepër po flasim për punime që qëndrojnë nën ujë 60-70 metra poshtë dhe kërkojnë investime teknike të një lloji shumë të specializuar për të bërë vlerësimin në kohë të nevojave të projektit dhe nga zbërthimi i agregateve, të punimeve është arritur në konstatimin se ka nevojë për punime shtesë. Çdo projekt infrastrukturor e ka një fond kontigjence dhe në rastin më të mirë ka një fond kontigjence që e shoqëron për rastet kur ka punime të paparashikuara.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Unë fola për shifrat që janë këtu, nuk fola fare për fondin e kontigjencës, për punime të paparashikuara, që i njoh, i di, sepse kam eksperiencë shumë të madhe pune, por fola thjesht për asistencën teknike. Po e bëj ndryshe pyetjen që ta kuptoni më mirë: 461 e 250 mijë euro që ishin planifikuar për asistencë teknike, pse nuk u përdorën për asistencë teknike dhe sot rezultojnë të lira, që kalojnë në zërin “investime”, të 15 - milionëshi? Kjo është pyetja që po të bëj.

Pyetja e dytë, meqenëse KESH-i sot është me fitim, pse duhet t’i harxhojmë? Shyqyr që nuk i kemi harxhuar, shyqyr që i keni planifikuar gabim, që doni t’i jepni 461 mijë euro asistencë teknike dhe nuk i keni përdorur. Lërimi këto, t’ia kthejmë Bankës Botërore dhe i kemi borxh 15 milionë dhe jo 50 milionë e ca. Këto ishin dy çështjet që ngrita dhe jo problemet e punëve të paparashikuara e të tjera. Pyetja është shumë e thjeshtë, por gjithsesi jam i kënaqur nga pyetja që bëra dhe jo nga përgjigjja.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Po, zoti Elezi.

Fatmir Elezi - Faleminderit, zoti kryetar!

Në lidhje me pyetjen e zonjës Caka dua të sqaroj se jam këtu si inxhinier elektrik, si person teknik, specialist pranë KESH-it. Zonjës Caka do t’i sugjeroj që t’i drejtohet institucionalisht KESH-it, pasi nuk kam një përgjigje në lidhje me çështjet që ngriti, pasi nuk e njoh si çështje.

Ulsi Manja - Po, zonja Caka.

Silva Caka- Meqenëse korporata është një institucion në varësi të ministrisë, e njëjta pyetje vlen edhe për zonjën zëvendësministre; a mund t’i përgjigjeni?

Dorina Çinari- Unë kam dijeni vetëm për faktin që Sekretariati i Komunitetit të Energjisë i është drejtuar KESH-it për një çështje të tillë dhe në këtë moment nuk kam informacion shtesë. Nëse kërkon një informacion të detajuar, do t’jua përgatisim.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka. Ka diskutime?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Meqenëse u kënaqa nga pyetja dhe nuk u kënaqa nga përgjigja, kam të drejtë të bëj diskutim, i cili është ekonomik, është për projektin në fjalë, pavarësisht se jam këtej nga ana e opozitës, nuk kam të bëj me pyetjet e opozitës që nuk kishin lidhje me projektligjin, siç ishin pyetjet që bëri zonja.

Ne duhet të jemi dorështrënguar dhe të kursyer me fondet që miratojmë. Ne na e kanë sjellë dhe e kemi miratuar huan, e cila është e të gjithë shqiptarëve. Nëse sot na rezulton një diferencë prej 461 mijë eurosh, nuk janë pak, unë propozoj që kjo shumë të mos rialloket, përkundrazi të financohet nga vetë fitimi që ka KESH-i dhe 461 - mijëshi të jetë më pak në investimin që është marrë nga Banka Botërore. Kjo është më se normale. Kjo dua që të kuptohet edhe nga përfaqësuesit e ministrisë. Meqenëse është marrë një kredi e tillë, është planifikuar në mënyrë të gabuar me sa shikoj, nuk është përdorur nga asistenca teknike, shqyr që nuk është përdorur, vijmë tek ajo që kemi thënë dikur: ajo që nuk është përdorur, të mos përdoret, që të mos rëndojë buxhetin e shqiptarëve me huanë që kemi marrë nga Banka Botërore, por nga fitimi që ka KESH-i që në këto momente është 5 milionë a më shumë, të përdorë këtë lloj investimi prej 461 - mijëshit që i duhet nëse kërkohet të rrisë mallrat dhe punimet në këtë digë.

Nuk jam kundër investimit të digës dhe riallokimit të fondit, absolutisht, por jam për ndryshim destinacioni. Destinacioni është që të mos përdoren këto 461 mijë nga Banka Botërore, por të përdoren nga fitimi i tij.

Ulsi Manja – Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni - Zoti kryetar, dua të bëj një diskutim të shkurtër lidhur me këtë shqetësim në mbështetje të kolegut Fino, se nuk ka lidhje me rastin konkret, por me një tërësi projektesh ku konstatohen parashikime të zërit “shpenzime konsulence të nivelit të lartë”. Disa herë është konstatuar se në faza të ndryshme të projektit ka pasur mundësi për lëvizje të këtij zëri nga “konsulenca” tek “investimet”. Kjo tregon se përllogaritjet janë fiktive në fillim. Nuk bëhet me faj ministria në këtë rast, sepse ajo është diskutuar në vitin 2012 si gjithmonë me qeverinë e kaluar, me qeverinë e djathtë, por mendoj se ka vend për t’u parë edhe nga qeveritë tona. Nuk e kemi luksin me këto kredi, që siç tha zoti Fino janë kredi që, interesat e tyre nuk paguhen lirë, që ne të paguajmë kosto të tilla të larta për konsulencën. Në raste të ndryshme shkon edhe 20%-30%, është tej çdo norme logjike të kredimarrjes dhe të projekteve. Për këtë arsye e gjej me vend ta mbështes. Ministria të shikojë filtrat në

projekte të ndryshme, jo thjesht të fushës së energjetikës. Jam dakord, është një investim i domosdoshëm, ka dalë domosdoshmëria në punë e sipër, shpenzime të paparashikuara, asnjëri nuk jemi kundër, por për metodologjinë e llogaritjes së zërave duhet kujdes, të mos paguajmë kur nuk është e nevojshme. Do të marrim çdo kredi të nevojshme, kur duhet, por për atë që është e domosdoshme dhe jo gjëra kot. Shpesh këto projekte nuk janë dhe aq eficiente, më shumë marrin specialistë të huaj, konsulentët e kredimarrësve të Bankës Botërore e të tjera.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti kryetar!

Unë e kuptoj shqetësimin e kolegëve, është shumë e drejtë ajo që thotë zoti Fino, se duhet të jenë shumë të kujdesshëm për ratifikimin e marrëveshjeve, por që në fillim u tha se kjo marrëveshje është e vitit 2012. Ne kemi qenë shumë kritikë në këtë sallë për këto abuzime që bëheshin me pjesën e konsulencës edhe deri në 1 milion -1 milion e 200 mijë euro e të tjerë. Kjo do të thotë se ne do të jemi shumë të vëmendshëm, por nuk mund t'i kërkojmë tani llogari një drejtuesi të ri, zonjës zëvendësministre. Duke marrë parasysh të gjitha shqetësimet që ka ngritur zoti Fino në të gjithë diskutimin e aktmarrëveshjeve, besoj do t'ia përcillni edhe ministres, zonjës Balluku, se të gjitha aktmarrëveshjet që do të vijnë nga sot e tutje në parlament, sidomos në Komisionin e Ligjeve do të vlerësohen nën këndvështrimin, që me të drejtë, zoti Fino e ka ngritur vazhdimisht për të qenë edhe për llogaritjet e sakta, jo abuzive në përcaktimin e afateve e të tjerë, që të mos ndodhë që marrëveshjet të vijnë disa herë për t'u riparë.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Ka diskutime të tjera nga kolegët?

Bashkim Fino- Nuk mora përgjigje nga ministria. Ajo që tha zonja Hysi dhe kolegët nuk ka të bëjë me projektin, investimi duhet të bëhet. Propozimi im është shumë racional. KESH-i ka sot 5 milionë euro fitim. Nga fitimi i tij t'i paguajë këto lekë dhe të jetë më pak huaja e shqiptarëve. A mund ta bëjmë këtë gjë? Kaq. Më ktheni përgjigje: po apo jo, sepse bëra një propozim konkret. Të mos riallokojmë fondin këtu brenda huas që kemi marrë nga Banka Botërore, por ta riallokojmë nga fitimi i KESH-it dhe kredia të mbetet aq sa është, 15 milionë.

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

Ulsi Manja – Zoti Fino, ka një përgjigje zoti Elezi.

Fatmir Elezi – Faleminderit, zoti kryetar!

Më lejoni ta shpjegoj në vija të trasha, por më të qartë rrjedhën e këtyre investimeve, sesi janë përdorur këto fonde dhe pse ne kërkojmë rialokimin e këtyre fondeve nga zëri “4” në kategorinë e parë.

Rehabilitimi i elektromekanikëve, siguria e digave ka filluar që në vitin 2012, në bazë të një studimi fizibiliteti të vitit 2008.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni!

Zoti kryetar, për t’u mbyllur rehabilitimi elektronik, por edhe ai i portave të shkarkimit u bë përlllogaritja e fundit dhe u kërkuar një financim shtesë prej 12 milionë eurosh, i cili u aprovua në tetor të vitit të kaluar. Këta 12 milionë euro merrnin parasysht fondet e kursyera nga kreditë e mëparshme, këto janë thjesht fondet e kursyera, të cilat ishin të parashikuara që do të aprovoreshin, ishte vendosur se do të aprovoreshin 12 milionë euro. Kjo është ajo që doja t’i shpjegoja zotit Fino. Nuk është se ne po i përdorim për të njëjtin zë që në ligj ishte e parashikuar.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Nuk besoj se ka diskutime të tjera. Kalojmë në votimin në parim të projektligjit “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin shtesë të projektit “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr. 40/2012”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Një abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen. Në variantin siç ka ardhur nga qeveria nuk janë specifikuar nenet, por në praktikën e miratimit të këtyre marrëveshjeve dhe për sa i përket teknikës legislative do të ndahet në dy nene.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2 “Hyrja në fuqi”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi ky projektligj.

Së bashku me raportin përkatës t’i përcillet komisionit përgjegjës dhe më pas seancës plenare për votim.

Përpara se ta mbyll mbledhjen e komisionit për ditën e sotme, dua t'u bëj me dije kolegëve të Komisionit të Ligjeve raportin që ka mbërritur nga Komisioni i Pavarur për Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit nr. 115 të vitit 2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” për periudhën nëntor 2018- janar 2019. Ky raport i njoftohet Komisionit të Ligjeve dhe u vihet në dispozicion të gjithë kolegëve të Komisionit të Ligjeve. Po ashtu të bëhet publik në faqen e Kuvendit të Shqipërisë dhe do t'i vihet në dispozicion edhe Kryetarit të Kuvendit me qëllim që nëse do të ketë interesim edhe për seancën plenare, ky raport mund t'u kalojë të gjithë kolegëve të tjerë deputetë.

Mbledhja e radhës do të jetë nesër, ora dhe rendi i ditës do t'ju njoftohen nga sekretaria e komisionit.

Ditë të mbarë!

Faleminderit!